



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 4729 prot.

Vlorë, më 29.03 2021

Nr. 28 VENDIM
Datë 29.03 2021

**PËR MIRATIMIN E VENDEVE PUBLIKE PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE
PROPAGANDISTIKE NGA SUBJEKTET ZGJEDHORE NË FUNKSION TË
ZGJEDHJEVE TË DATËS 25.04.2021 PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 8, pika 2, neni 9.1, pika 1.1/ a dhe b . neni 64 , pika a dhe gj , si dhe në Ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Neni 79

VENDOSA:

Të miratojë vendet publike për afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore në funksion të zgjedhjeve të datës 25.04.2021 për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë si më poshtë :

1. Për Qendrat e Votimit të Njësi Administrative dhe të fshatrave në të cilat subjektet zgjedhore kanë zyrat përkatëse në një distancë jo më shumë se 5 metër largësi prej tyre .
2. Pranë godinave të zyrave lokale të subjekteve zgjedhore në qytetin e Vlorës në distancë jo më shumë se 5 metër largësi prej tyre .
3. Pranë zyrave zgjedhore të subjekteve zgjedhore sipas kërkesës së arsyetuar të çdo subjekti në distancë jo më shumë se 5 metër largësi .

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

